



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 160

Tiranë – E enjte, 24 gusht 2017

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Urdhër i ministrit të Financave nr. 96, datë 18.8.2017	Për një ndryshim në urdhrin nr. 94, datë 3.8.2017 “Për delegim kompetence”..... 7425
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 5080, datë 21.8.2017	Për delegim kompetence..... 7425
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 118, datë 27.7.2017	Mbi miratimin e rregullave për publikimin e të dhënave bazë të tregut të energjisë elektrike..... 7426
	Vendim <i>(i shkurtuar)</i> për shpalljen të vdekur të shtetasit Stiliano Elmazi.. 7441



## URDHËR

Nr. 96, datë 18.8.2017

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR.  
94, DATË 3.8.2017 “PËR DELEGIM  
KOMPETENCE”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 6 të ligjit nr. 9000, datë 30.12.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të nenit 11 të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

## URDHËROJ:

1. Pika 1 e urdhrit nr. 94, datë 3.8.2017 ndryshon si vijon:

**ishte** “për periudhën 3.8.2017 deri më 17.8.2017”, **bëhet** “deri në një urdhër të dytë”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Financave, z. Erjon Luçi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE  
**Helga Vukaj**

## URDHËR

Nr. 5080, datë 21.8.2017

**PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 28, 29 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 6 të ligjit nr. 9000, datë 30.12.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11 të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

## URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë, zëvendësministrit të Ministrisë së Drejtësisë, znj. Etilda Gjonaj (Saliu),

për drejtimin administrativ të institucionit, me përjashtim të kompetencave që ligji ia njeh shprehimisht Ministrit të Drejtësisë dhe që kërkojnë nxjerrjen e urdhrave apo udhëzimeve përkatëse.

2. Në ushtrim të kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë, sipas pikës 1 të këtij urdhri, zëvendësministri ushtron ndër të tjera këto përgjegjësi kryesore:

a) Trajton dhe nënshkruan përgjigjet zyrtare drejtuar institucioneve shtetërore, personave fizikë ose juridikë, publikë ose privatë, për të gjitha çështjet që janë brenda fushës së veprimtarisë së Ministrisë së Drejtësisë dhe që lidhen me ushtrimin e funksionit të drejtimit administrativ të institucionit.

b) Ndjek dhe kontrollon veprimtarinë e nëpunësve të aparatit të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe institucioneve të varësisë së Ministrisë së Drejtësisë.

c) Ndjek bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën penale dhe civile dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare, ku shteti shqiptar është palë, realizimin e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet kompetente të shteteve të tjera, si dhe me organizmat ndërkombëtarë, duke trajtuar dhe nënshkruar të gjitha aktet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet juridiksionale me jashtë.

ç) Është person i autorizuar për ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrjen e ligjshmërisë dhe për ushtrimin normal të veprimtarisë së SHKBB-së.

d) Ndjek dhe përgjigjet për realizimin e politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e drejtësisë.

dh) Kujdeset për organizimin dhe funksionimin e shërbimeve, që lidhen me sistemin e drejtësisë dhe veprimtarinë e institucioneve të varësisë së Ministrisë së Drejtësisë.

e) Bën ndarjen dhe mbikëqyr realizimin e detyrave nga nëpunësit e Ministrisë së Drejtësisë, në funksion të drejtimit dhe administrimit të përditshëm të veprimtarisë së Ministrisë së Drejtësisë.

ë) Kryen çdo detyrë tjetër të caktuar rast pas rasti nga Ministri i Drejtësisë.

3. Në ushtrimin e kompetencave sipas këtij urdhri, zëvendësministri ndihmohet dhe mbështetet nga sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, ose personi që ushtron detyrat e tij në



rast mungese, si dhe financohet nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë. Zëvendësministri ndalohej të nëndelegojë te një organ i tretë kompetencat e përfituara përmes këtij akti delegimi.

4. Kompetencat e titullarit të Ministrisë së Drejtësisë, për çështjet e përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij urdhri, do të ushtrohen nga data 23.8.2017 dhe deri në shfuqizimin e këtij urdhri. Zëvendësministri për ushtrimin e kompetencave sipas këtij urdhri, informon periodikisht Ministrin e Drejtësisë.

5. Ngarkohet sektori i arkiv-protokollit dhe redaktimit gjuhësor, për njoftimin e këtij urdhri, nëpunësve të aparatit të Ministrisë së Drejtësisë dhe të të gjithë titullarëve të institucioneve të varësisë.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Drejtësisë, znj. Etilda Gjonaj (Saliu) dhe sektori i arkiv-protokollit dhe redaktimit gjuhësor.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË  
**Gazment Bardhi**

#### VENDIM

Nr. 118, datë 27.7.2017

### MBI MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR PUBLIKIMIN E TË DHËNAVE BAZË TË TREGUT TË ENERJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 22, 51 dhe 97 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, pikat 1 dhe 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 519, datë 13.7.2016, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, të nenit 15 dhe 26 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016 dhe rekomandimet nga Sekretariati i Energjisë (Vjenë, Austri) datë 5.4.2017, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.7.2017, pasi shqyrtoi relacionin në lidhje me hartimin e Rregullave për publikimin e të dhënave bazë të tregut të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 59, datë 18.4.2017, bordi i ERE-s ka vendosur “Për fillimin procedurës për

miratimin e rregullave për publikimin e të dhënave bazë të tregut të energjisë elektrike”.

- Kjo rregullore është konsultuar me të gjitha palët e interesit, si: KESH sh.a., OST sh.a., Ministria e Energjisë dhe Industrisë, OSHEE sh.a., Autoriteti i Konkurrencës, Shoqata AAES, Shoqata FIAA, Shoqata AREA, Shoqata e prodhuesve të vegjël të energjisë elektrike, Albania Centre For Energy Regulation & Conservation – ACERC.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### VENDOSI:

1. Miratimin e “Rregullave për publikimin e të dhënave bazë të tregut të energjisë elektrike” (bashkëlidhur).

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
**Petrit Ahmeti**

### RREGULLAT PËR PUBLIKIMIN E TË DHËNAVE BAZË TË TREGUT TË ENERJISË ELEKTRIKE

#### 1. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Kjo Rregullore hartohet në zbatim të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, ligjit nr. 9501, datë 3.4.2006, “Për ratifikimin e Traktatit për krijimin e Komunitetit të Energjisë”, Rregullores së Komisionit Evropian nr. 543/2013, të datës 14 qershor 2013, “Mbi paraqitjen dhe publikimin e të dhënave në tregjet e energjisë elektrike dhe ndryshimin e shtojcës së Rregullores (KE) nr. 714/2009, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit” dhe vendimit nr. 2015/01/PHLG-EnC, datë 24.6.2015, të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë.

#### 1.1 OBJEKTI

1.1.1 Kjo Rregullore përcakton tërësinë e rregullave mbi procedurat dhe kërkesat për të dhëna lidhur me publikimin në kohë të të dhënave mbi konsumin, transmetimin, prodhimin dhe tregun balancues, si të dhëna kyçe të tregut, dhe njëkohësisht disponibilitetin e tyre për të gjithë



pjesëmarrësit e tregut të energjisë, si një parakusht për funksionimin e tregut të energjisë elektrike në mënyre transparente dhe jo diskriminuuese.

1.1.2 Kjo Rregullore gjithashtu përcakton në mënyrë të detajuar detyrimet e Operatorit të Sistemit të Transmetimit, Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, Operatorit të Sistemit të Mbyllur të Shpërndarjes, prodhuesve të energjisë elektrike dhe njësisë të konsumit, në lidhje me publikimin e të dhënave të tregut dhe çështjeve të tjera të nevojshme për publikimin e tyre.

## 1.2 DORËZIMI DHE PUBLIKIMI I TË DHËNAVE

1.2.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të dërgojë për publikim në kohë të gjithë të dhënat përkatëse në lidhje me ngarkesën totale të parashikuar, si dhe ngarkesën faktike, disponueshmërinë dhe përdorimin e kapacitetit rezervë të transmetimit dhe kapacitetit të interkonjeksioneve, parashikimi i gjenerimit dhe gjenerimi faktik dhe të dhënat për balancimin e tregut të energjisë elektrike të përcaktuara në këto rregulla (këtej e tutje do të quhen: të dhënat bazë të tregut) në përputhje me ligjin i cili rregullon sektorin e energjisë elektrike (këtej e tutje do të quhet thjeshtë ligji).

1.2.2 Operatori i Sistemit të Transmetimit do të sigurojë dërgimin për publikim të të dhënave bazë të tregut brenda afateve dhe përmbajtjes të përcaktuara në këto Rregulla në një mënyrë që këto të dhëna të bëhen të disponueshme në Platformën Qendrore të Transparencës së Informacionit (EMFIP), në Rrjetin Europian të Operatorëve të Sistemit të Transmetimit për Energjinë Elektrike (këtej e tutje do të quhet thjeshtë ENTSO-E) për të gjithë pjesëmarrësit e tregut.

1.2.3 ENTSO-E publikon në Platformën Qendrore të Transparencës së Informacionit të gjitha të dhënat të cilat Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet t'i dorëzojë/dërgojë ENTSO-E-së në përputhje me këtë Rregullore.

1.2.4 Për të publikuar të dhënat bazë të tregut në përputhje me këto rregulla, Operatori i Sistemit të Transmetimit përdor të gjithë informacionin e vënë në dispozicion nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Operatori i Sistemit të Mbyllur të Shpërndarjes, prodhuesit e energjisë elektrike (njësitë prodhuese dhe gjeneruese) dhe njësitë e konsumit, nëse këto të dhëna janë dorëzuar tek Operatori i Sistemit të Transmetimit brenda afatit

dhe sipas përmbajtjes të përcaktuar në këto rregulla.

1.2.5 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të dorëzojë tek Operatori i Sistemit të Transmetimit informacionin e mëposhtëm:

- kapacitetin e instaluar gjenerues të të gjithë njësisve gjeneruese të lidhura në rrjetin e shpërndarjes, ose sistemin e mbyllur të shpërndarjes;

- gjenerimin total faktik në sistemin e shpërndarjes apo në sistemin e mbyllur të shpërndarjes për intervalin llogaritës;

- gjenerimin faktik nga të gjitha tipat gjenerues lidhur në sistemin e shpërndarjes apo në sistemin e mbyllur të shpërndarjes për intervalin llogaritës;

- gjenerimin faktik nga centralet fotovoltaike dhe nga centralet e erës në sistemin e shpërndarjes apo në sistemin e mbyllur të shpërndarjes;

- parashikimin e gjenerimit total të ditës në avancë në sistemin e shpërndarjes dhe sistemin e mbyllur të shpërndarjes;

- parashikimin e ditës në avancë të gjenerimit nga centralet fotovoltaike dhe nga centralet e erës në sistemin e shpërndarjes apo në sistemin e mbyllur të shpërndarjes.

1.2.6 Prodhuesit e energjisë (njësitë prodhuese dhe gjeneruese) duhet të dorëzojnë tek Operatori i Sistemit të Transmetimit informacionin e mëposhtëm:

- kapacitetin e instaluar total i gjeneruesve të lidhur në sistemin e transmetimit;

- kapacitetin e instaluar të çdo njësie gjeneruese të lidhur në Sistemin e Transmetimit (të klientëve në treg të liberalizuar);

- gjenerimin faktik të çdo njësie gjeneruese;

- gjenerimin faktik nga centralet fotovoltaike dhe nga centralet e erës;

- gjenerimin faktik të prodhuesve të lidhur në sistemin e transmetimit për intervalin llogaritës;

- parashikimin e gjenerimit total të ditës në avancë të gjeneruesve në sistemin e transmetimit;

- parashikimin e ditës në avancë të gjenerimit nga centralet fotovoltaike dhe nga centralet e erës në sistemin e transmetimit;

- mosdisponueshmërinë faktike të njësisve gjeneruese;

- mosdisponueshmërinë faktike të njësisve prodhuese;

- mosdisponueshmërinë e planifikuar të njësisve gjeneruese;



- mosdisponueshmërinë e planifikuar të njëjësive prodhuese;

- marzhin e parashikuar të një viti në avancë.

1.2.7 Njësiti e konsumit duhet të dorëzojnë tek Operatori i Sistemit të Transmetimit informacionin e mëposhtëm:

- mosdisponueshmërinë e planifikuar të njëjësive të konsumit;

- ndryshimet në disponueshmërinë faktike të njëjësive të konsumit.

1.2.8 Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të sigurojë informacionin në vijim:

- vlerën e skedular të shkëmbimit ndërkuftar të energjisë elektrike;

- parashikimin e ngarkesës për ditën/javën/ muajin/vitin në avancë;

- marzhin e parashikimit për vitin në avancë;

- projektet zhvillimore;

- ndërprerjet e planifikuara në sistemin e transmetimit;

- ndryshimet në disponueshmërinë e inter-konjeksioneve dhe rrjetit të transmetimit;

- kapacitetin e parashikuar ndërkuftar;

- kapacitetin e ofruar ndërkuftar;

- raportin vjetor rreth elementeve kritike të rrjetit që kufizojnë kapacitetet e ofruara;

- përdorimin e kapaciteteve të transmetimit - ankandet;

- përdorimin e kapaciteteve të transmetimit - alokimet;

- kapacitetin total të nominuar;

- kapacitetin total të alokuar;

- çmimet në ditën në avancë në tregun e organizuar të energjisë elektrike;

- totalin e shkëmbimeve tregtare të skeduluara;

- flukset fizike ndërkuftare;

- menaxhimin e kongestionit - ridispeçerimi

- menaxhimin e kongestionit - tregtimi ndërkuftar (*counter trading*);

- raportin e menaxhimit të kongestionit;

- rregullat e balancimit;

- sasinë e rezervës balancuese sipas kontratës;

- çmimet e kapacitetit rezervë të rezervave balancuese;

- sasinë e ofertave të pranuar;

- sasinë e rezervave të balancimit të aktivizuara;

- çmimin e rezervave të balancimit të aktivizuara;

- çmimet e disbalancave;

- sasinë totale të disbalancave;

- balancën mujore financiare;

- sasinë totale të ofertave për aktivizimin e balancimit ndërzonal;

- çmimet ndërzonale të kërkesë - ofertave për disbalancat;

- sasinë e energjisë së aktivizuar midis zonave për balancimin.

1.2.9 Subjektet e referuara në pikat 1.2.4, 1.2.5 dhe 1.2.6 janë përgjegjës për afatin, plotësinë dhe saktësinë e të dhënave të dorëzuara tek Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe konsiderohen si zotërues primarë të të dhënave që ata dorëzojnë.

Përveçse kur është parashikuar ndryshe në këtë rregullore, si zotërues primar i të gjitha të dhënave të tjera konsiderohet Operatori i Sistemit të Transmetimit.

1.2.10 Zotëruesit primarë të të dhënave i dorëzojnë të dhënat tek Operatori i Sistemit të Transmetimit në përputhje me pikat 3 deri 6. Ata sigurojnë që të dhënat që i dorëzohen Operatorit të Sistemit të Transmetimit të jenë të plota, të cilësisë së kërkuar dhe të siguruara në atë mënyrë që e lejon Operatorin e Sistemit të Transmetimit të përpunojë dhe të dërgojë të dhënat tek ENTSO-E në kohën e duhur.

1.2.11 Të dhënat duhet të dorëzohen në përputhje me manualin e procedurave të ENTSO-E-së, i cili paraqitet në shtojcën A të kësaj rregulloreje.

Manuali i procedurave specifikon:

a) detajet dhe formën e dorëzimit të të dhënave;

b) mënyrat dhe format e standardizuara të komunikimit dhe shkëmbimit të të dhënave ndërmjet zotëruesve primarë të të dhënave, Operatorit të Sistemit të Transmetimit, ofruesve të të dhënave dhe ENTSO-E-së;

c) kriteret teknike dhe operacionale të cilat duhet të plotësohen nga ofruesit e të dhënave kur i ofrojnë të dhënat tek platforma qendrore e transparencës së informatave;

d) klasifikimin e duhur të llojeve të prodhimit, të referuar në pikën 5.

1.2.12 Operatori i Sistemit të Transmetimit do të publikojë në *web* të dhënat e përshtatshme në lidhje me operimin e sistemit të transmetimit për të përmbushur detyrime në lidhje me transparencën. Këto të dhëna në *web* duhet të jenë të aksesueshme nëpërmjet faqes zyrtare të internetit ([www.ost.al](http://www.ost.al)) dhe duhet të përfshijnë:

- të dhënat mbi ngarkesën;



- të dhëna mbi gjenerimin;
- të dhëna mbi transmetimin;
- të dhëna mbi balancimin;
- të dhëna mbi ndërprerjet;
- të dhëna mbi menaxhimin e kongjestioneve.

1.2.13 ERE siguron që zotëruesit primarë të të dhënave, Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe ofruesit e të dhënave të respektojnë detyrimet e tyre sipas kësaj rregulloreje. Në rast të

mosdorëzimit në kohë të të dhënave nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Operatori i Sistemit të Mbyllur të Shpërndarjes, prodhuesit e energjisë elektrike (njësitë prodhuese dhe gjeneruese) dhe njësitë e konsumit pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit, ky i fundit do të informojë menjëherë ERE-n për të proceduar për shkeljen administrative sipas parashikimeve të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

## 2. PËRKUFIZIME DHE SHKURTIME

2.1 PËRKUFIZIME Termat e përdorur në këtë rregullore kanë kuptimin e mëposhtëm:	
Rezerva balancuese	nënkupton të gjithë kapacitetet e disponueshme për OST-në, që blihen <i>ex ante</i> ose në kohë reale, ose sipas detyrimeve ligjore, për qëllime të balancimit.
Gjenerimi neto	nënkupton prodhimin neto faktik në njësitë e lidhura në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes, brenda një zonë kontrolli në një interval llogaritës.
Njësi konsumi	nënkupton një njësi e cila konsumon energji elektrike për nevoja të veta, me përjashtim të OST-së dhe Operatorëve të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH-ve).
Njësi gjeneruese	nënkupton një gjenerator të energjisë elektrike i cili i përket një njësie prodhuese.
Njësi prodhuese	nënkupton një objekt për gjenerimin e energjisë elektrike me një apo më shumë njësi gjeneruese.
Javë	intervali kohor nga e hëna në orën 00:00 deri të dielën në orën 24:00.
Tipi i gjenerimit	gjenerimi i përcaktuar në varësi të burimit të përdorur për prodhimin e energjisë elektrike, përcaktuar sipas termave të kësaj rregulloreje: fosilet - (qymyr kaf/lignite, qymyr i zi, gaz qymyri, nafta, nënproduktet e naftës, gazit natyror); hidro - (me digë dhe derivacion); i rinovueshëm - (erë, energji diellore, energjia gjeotermike, biomasa dhe burime të tjera të rinovueshme sipas ligjit për energjitë e rinovueshme 7/2017).
Njësia kohore e balancimit	nënkupton periudhën e kohës për të cilën është caktuar çmimi për rezervat balancuese.
Zona e ofertimit ( <i>bidding zone</i> )	nënkupton hapësirën më të madhe gjeografike brenda së cilës pjesëmarrësit e tregut janë në gjendje të shkëmbejnë energji pa alokim të kapaciteteve
Alokimi i kapaciteteve	nënkupton atribuimin e kapaciteteve ndërzonale.
Zona e kontrollit	nënkupton pjesën koherente të sistemit të interkonektuar, të operuar nga një operator i vetëm i sistemit dhe përfshin ngarkesa të lidhura fizike dhe/ose njësi të gjenerimit, nëse ka.
Kapaciteti i transmetimit neto i koordinuar	nënkupton metodën e llogaritjes së kapaciteteve bazuar në parimin e vlerësimit dhe përcaktimit <i>ex ante</i> të shkëmbimit maksimal të energjisë në mes të zonave të afërta të ofertimit.
Elementi kritik i rrjetit	nënkupton një element të rrjetit brenda një zone ofertimi ose ndërmjet zonave të ofertimit, i cili merret parasysh në procesin e llogaritjes së kapaciteteve, i cili kufizon sasinë e energjisë që mund të shkëmbehet.
Balancimi ndërzonal i zonës së kontrollit	nënkupton skemën balancuese në të cilën OST-të mund të marrin oferta për aktivizim që vijnë nga zonat e OST-ve të tjera. Këtu nuk përfshihet



<i>(cross-control area balancing)</i>	ridispeçimi ose shpërndarja e energjisë emergjente.
Kapaciteti ndërzonar	nënkupton aftësinë e sistemit të interkonektuar për të akomoduar transferimin e energjisë ndërmjet zonave të ofertimit.
Valuta	është euroja ose leku (monedhe zyrtare vendëse) sipas detyrimit ligjor të përdorimit të secilës prej tyre në aktet ligjore përkatëse.
Koha e ndërprerjes ( <i>cut-off time</i> )	nënkupton pikën në kohë ku OST-ja duhet t'i konfirmojë të gjitha nominimet e përputhshme në treg. Koha e ndërprerjes i referohet jo vetëm tregjeve ditore ose brendaditore, por gjithashtu tregjeve të ndryshme që përfshijnë rregullimet e disbalanca dhe alokimin e rezervave.
Tregtimi ndërkufitar ( <i>counter trading</i> )	nënkupton shkëmbimin ndërzonar të iniciuar nga operatorët e sistemit ndërmjet dy zonave ofertuese për “çlirimin”/reduktimin e kongestionit fizik.
Ofrues i të dhënave	nënkupton subjektin që i dërgon të dhënat tek platforma qendrore e transparencës së informacionit.
Alokimi eksplisit	nënkupton alokimin vetëm të kapacitetit ndërzonar, pa përfshirë energjinë.
Parametrat e <i>Flow Based</i>	nënkupton marzhin disponibël të elementeve kritike të rrjetit së bashku me faktorët e ndjeshmërisë PTDF.
Faktor i ndjeshmërisë PTDF	nënkupton fluksin fizik në një element kritik shkaktuar nga ndryshimi i balancës së zonës së ofertimit.
Alokimi implicit	nënkupton metodën e menaxhimit të konxhëstioneve në të cilën energjia sigurohet në të njëjtën kohë me kapacitetin ndërzonar.
Njësia kohore e tregut	nënkupton periudhën për të cilën është vendosur çmimi i tregut ose periudhën e përbashkët më të shkurtër të mundshme për dy zona të ofertimit, në rast se njësitë kohore të tregut të tyre dallojnë nga njëra-tjetra.
Kapaciteti i ofruar	nënkupton kapacitetin ndërzonar të ofruar në treg nga alokuesi i kapacitetit të transmetimit.
E planifikuar	nënkupton një ngjarje të njohur <i>ex ante</i> nga zotëruesi primar i të dhënave.
Zotëruesi primar i të dhënave	nënkupton subjektin i cili i krijon të dhënat.
Profili	nënkupton kufirin gjeografik ndërmjet një zone ofertimi dhe disa zonave të afërta/fqinje të ofertimit.
Ridispeçerimi	nënkupton një masë e cila aktivizohet nga një ose disa operatorë të sistemit duke ndryshuar gjenerimin dhe/ose ngarkesën, në mënyrë që të ndryshohen flukset fizike në sistemin e transmetimit dhe të lehtësohen kongestionet fizike.
Ngarkesa totale	duke përfshirë humbjet pa energjinë e përdorur për grumbullimin e energjisë, nënkupton ngarkesën e barabartë me gjenerimin dhe çdo lloj importi nga e cila zbriten eksportet dhe energjia e përdorur për grumbullimin e energjisë.
Alokuesi i kapaciteteve të transmetimit	nënkupton subjektin e autorizuar nga OST-ja për menaxhimin e procesit të alokimit të kapacitetit ndërzonar.
Ngarkesa vertikale	nënkupton sasinë e përgjithshme të energjisë që del jashtë rrjetit të transmetimit në drejtim të rrjetit të shpërndarjes, tek konsumatorët fundorë të lidhur drejtpërdrejt ose tek pjesa konsumuese e gjenerimit.
Marzhi i parashikimit për vitin në avancë	nënkupton diferencën ndërmjet parashikimit vjetor të kapaciteteve gjeneruese në dispozicion dhe parashikimit vjetor të ngarkesës maksimale të përgjithshme, duke marrë parasysh parashikimin e kapacitetit të përgjithshëm të gjenerimit, parashikimin e gjenerimit në dispozicion dhe parashikimin e rezervave të kontraktuara për shërbimet ndihmëse.
Koha	nënkupton kohën lokale në Bruksel.



Platforma Qendrore të Transparencës Informacionit	Platforma Qendrore e Transparencës së Informacionit është një platformë elektronike në dispozicion për publikun, pa pagesë, me anë të internetit dhe është në dispozicion të paktën në gjuhën angleze, e krijuar nga Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmisionit për Energji (ENTSO-E) në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në Rregulloren e Komisionit Evropian nr. 543/2013 e datës 14 qershor 2013.
Eksport i deklaruar	është dispeçerimi i energjisë elektrike që i korrespondon sasisë së energjisë elektrike që lëvrohet njëkohësisht në një vend tjetër si import i deklaruar mbi bazën e një marrëdhënieje kontraktuale.
Import i deklaruar	është energjia elektrike që lëvrohet në një vend, e cila, në të njëjtën kohë, dispeçerohet si eksport i deklaruar nga një vend tjetër.
Termat e tjerë të përdorur në këtë rregullore kanë kuptimin sipas ligjit dhe akteve të tjera të miratuara në zbatim të ligjit që rregullojnë operimin e sistemit të transmetimit, operimin e tregut dhe shpërndarjen e kapacitetit ndërkufitar të sistemit të transmetimit.	

### 3. TË DHËNAT BAZË TË TREGUT MBI KONSUMIN

#### 3.1. INFORMACIONI MBI NGARKESËN E PËRGJITHSHME

3.1.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit, për zonën e tij të kontrollit, bën llogaritjen dhe i dërgon ENTSO-E-së, për zonën e vet përkatëse të ofertimit ngarkesën totale të Sistemit të Transmetimit (ST) (përfshirë humbjet në ST), për çdo orë vlerën mesatare të ngarkesës së përgjithshme aktuale brenda një intervali kohor sipas formulës në vijim:

Ngarkesa totale faktike = gjenerimi neto - export + import

Në rast se prodhuesi i energjisë elektrike nuk është në gjendje të ofrojë një matje të energjisë elektrike në transmetim, atëherë ai mund ta ofrojë atë tek njësitë matëse të balancimit.

3.1.2 Njësitë gjeneruese duhet të dorëzojnë pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit të dhëna lidhur me gjenerimin total të njërive lidhur me transmetimin për një interval të caktuar llogaritës.

3.1.3 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe Operatori i Sistemit të mbyllur të Shpërndarjes duhet të dorëzojnë tek Operatori i Sistemit të Transmetimit të dhëna mbi gjenerimin faktik të përgjithshëm të njërive të lidhura në rrjetin e shpërndarjes ose në sistemin e mbyllur të shpërndarjes, 30 minuta pas çdo intervali llogaritës.

3.1.4 Informacioni referuar pikës 3.1.1 duhet të publikohet për çdo orë, jo më vonë se një orë pas periudhës së operimit.

#### 3.2 PARASHIKIMI I NGARKESËS TOTALE TË DITËS NË AVANCË

3.2.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit, për zonën e tij të kontrollit, bën llogaritjen dhe i dërgon ENTSO-E për zonën e vet përkatëse të ofertimit parashikimin për ditën në avancë të ngarkesës totale për njësi kohore të tregut.

3.2.2 Ky informacion jepet jo më vonë se dy orë para mbylljes së portës së tregut për ditën në avancë dhe përditësohet kur ndodhin ndryshime të rëndësishme.

#### 3.3 PARASHIKIMI I NGARKESËS TOTALE TË JAVËS NË AVANCË

3.3.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit, për zonën e tij të kontrollit, bën llogaritjen dhe i dërgon ENTSO-E-së për zonën e vet përkatëse të ofertimit parashikimin për javën në avancë të ngarkesës totale për secilën ditë të javës së ardhshme, ku çdo ditë duhet të përfshijë vlerën maksimale dhe minimale të ngarkesës totale.

3.3.2 Informacioni duhet të publikohet çdo të premte jo më vonë se dy orë para mbylljes së portës së tregut të ditës në avancë dhe përditësohet kur ndodhin ndryshime të rëndësishme.

#### 3.4 PARASHIKIMI I NGARKESËS TOTALE TË MUAJIT NË AVANCË

3.4.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit për zonën e tij të kontrollit bën llogaritjen dhe i dërgon ENTSO-E-së për zonën e vet përkatëse të ofertimit parashikimin për muajin në avancë të ngarkesës totale për secilën javë të muajit të ardhshëm, ku çdo javë duhet të përfshijë sasinë maksimale dhe minimale të ngarkesës totale.

3.4.2 Informacioni duhet të publikohet jo më vonë se një javë para muajit të dorëzimit dhe të





përditësohet kur ndodhin ndryshime të rëndësishme.

### 3.5 PARASHIKIMI I NGARKESËS TOTALE TË VITIT NË AVANCË

3.5.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit, për zonën e tij të kontrollit, bën llogaritjen dhe i dërgon ENTSO-E-së, për zonën e vet përkatëse të ofertimit, parashikimin për vitin në avancë të ngarkesës totale për secilën javë të vitit të ardhshëm, ku çdo javë duhet të përfshijë sasinë maksimale dhe minimale të ngarkesës.

3.5.2 Informacioni duhet të publikohet jo më vonë se 15 ditë kalendarike të muajit para vitit me të cilin kanë të bëjnë të dhënat.

### 3.6 INFORMACIONI NË LIDHJE ME MOSDISPONUESHMËRINË E NJËSIVE TË KONSUMIT

3.6.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit, për zonën e tij të kontrollit, i dërgon ENTSO-E-së informacion për mosdisponueshmërinë e planifikuar prej 100 MW ose më tepër të një njësie të konsumit, duke përfshirë ndryshimet prej 100 MW ose më tepër në mosdisponueshmërinë e planifikuar të njësive të konsumit, që zgjasin të paktën një njësi kohore të tregut.

3.6.2 Njësitë e konsumit të vendosura në zonën e kontrollit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit llogarisin dhe i dorëzojnë të dhënat e përcaktuara në paragrafin 3.6.1, duke specifikuar:

- a) zonën e ofertimit;
- b) kapacitetin disponibël për njësi kohore të tregut gjatë ngjarjes;
- c) arsyen e mosdisponueshmërisë;
- d) datën e parashikuar të fillimit dhe mbarimit (ditën, orën) të ndryshimit në disponueshmëri.

3.6.3 Njësitë e konsumit duhet të dorëzojnë tek Operatori i Sistemit të Transmetimit informacionin sipas pikës 3.6.2 sa më parë të jetë e mundur por jo më vonë se 1 orë pas marrjes së vendimit.

3.6.4 Informacioni i përcaktuar në pikën 3.6.1 publikohet në formë të përmbledhur për zonën e ofertimit, duke identifikuar shumën e kapacitetit të konsumit që nuk është disponibël për njësinë kohore të tregut, gjatë një periudhe të caktuar, sa më shpejt që është e mundur, por jo më vonë se një orë pas marrjes së vendimit në lidhje me mosdisponueshmërinë e planifikuar.

### 3.7 NDRYSHIMET NË DISPONUESHMËRINË FAKTIKE TË NJËSIVE TË KONSUMIT

3.7.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit, për zonën e tij të kontrollit, i dërgon ENTSO-E-së informacion për ndryshimet në disponueshmërinë aktuale të njësisë së konsumit me vlerësim të energjisë prej 100 MW ose më tepër.

3.7.2 Njësitë e konsumit duhet të dorëzojnë tek Operatori i Sistemit të Transmetimit informacionin e mëposhtëm mbi njësitë e konsumit me kapacitet më të madh ose të barabartë me 100 MW:

- a) zonën e ofertimit;
- b) kapacitetin disponibël për njësi kohore të tregut gjatë ngjarjes;
- c) arsyen e mosdisponueshmërisë;
- d) datën e fillimit dhe datën e parashikuar të mbarimit (ditën, orën) të ndryshimit në disponueshmëri.

3.7.3 Njësitë e konsumit duhet të dorëzojnë tek Operatori i Sistemit të Transmetimit informacionin sipas pikës 3.7.2 jo më vonë se 30 minuta pas ndryshimit të mosdisponueshmërisë së njësive të konsumit.

3.7.4 Informacioni duhet të publikohet jo më vonë se një orë (H+1) pas ndryshimit të disponibilitetit.

### 3.8 PARASHIKIMI I MARZHIT NJË VIT AVANCË

3.8.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit, për zonën e tij të kontrollit, llogarit dhe i dërgon ENTSO-E-së, për zonën e vetë përkatëse të ofertimit, marzhin e parashikuar për vitin në avancë, të vlerësuar në njësi kohore të tregut.

3.8.2 Marzhi i parashikuar i një viti në avancë përcaktohet si diferencë ndërmjet gjenerimit neto vjetor të parashikuar dhe ngarkesës totale vjetore të parashikuar, duke marrë në konsideratë kapacitetin total gjenerues të parashikuar, disponibilitetin e njësive gjeneruese dhe parashikimin e kapacitetit rezervë që do të kontraktohet për shërbimet ndihmëse.

3.8.3 Informacioni duhet të publikohet jo më vonë se një javë përpara javës në të cilën bëhet ankandë vjetor ose 15 ditë para fillimit të vitit me të cilin lidhen të dhënat.

3.8.4 Njësitë gjeneruese dhe Operatorët e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), të vendosura brenda zonës së kontrollit të Operatorit të



Sistemit të Transmetimit i ofrojnë atij të gjithë informacionin e nevojshëm për të përlogaritur të dhënat e referuara në pikën 3.8.1 deri në datë 1 të muajit nëntor.

#### 4. TË DHËNAT BAZË TË TREGUT PËR TRANSMETIMIN

##### 4.1 INFRASTRUKTURA E TRANSMETIMIT

4.1.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit do të hartojë dhe i dërgon ENTSO-E-së informacion për ndryshimet e mundshme të elementeve të rrjetit dhe projekteve të interkonjeksionit që do të zhvillohen në të ardhmen, duke përfshirë ato elemente që konsistojnë në zhvillimin e rrjetit të transmetimit (zgjerimin e rrjetit nëpërmjet integritit të elementeve të reja apo demontimin e elementeve ekzistuese) brenda tri viteve të ardhshme. Ky informacion duhet të jepet vetëm për ato ndryshime në infrastrukturën e rrjetit që priten të kenë një ndikim prej të paktën 100 MW në kapacitetin e shkëmbimit ndërmjet zonave të ofertimit (*bidding zone*) ose në kufirin gjeografik midis këtyre zonave. Ky informacion duhet të përfshijë:

- a) identifikimin e aseteve;
- b) zonat e prekura;
- c) tipin e asetit;
- d) impaktin në kapacitetin e interkonjeksionit sipas drejtimit ndërmjet zonave të ofertimit;
- e) kohën e parashikuar për t'u përfunduar.

4.1.2 Informacioni duhet të publikohet një javë përpara alokimit vjetor të kapaciteteve, por jo më vonë se dita e 15-të e muajit të fundit të vitit për të cilin bëhet alokimi. Informacioni do të përditësohet me ndryshimet përkatëse para mbylljes së muajve mars, qershor dhe shtator të vitit në të cilin kryhet alokimi.

##### 4.2 MOSDISPONUESHMËRIA E PLANIFIKUAR E INFRASTRUKTURAVE TË RRJETIT TË TRANSMETIMIT

4.2.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit, për zonën e tij të kontrollit, llogarit dhe i dërgon ENTSO-E-së informacion mbi mosdisponueshmërinë e planifikuar, duke përfshirë ndryshimet në mosdisponueshmërinë e planifikuar të interkonjeksioneve dhe në rrjetin e transmetimit që reduktojnë kapacitetet ndërzonale ndërmjet zonave të ofertimit për 100 MW ose më tepër, gjatë së paku një njësie kohore të tregut, duke specifikuar:

- a) identifikimin e aseteve në fjalë;
- b) vendndodhjen;
- c) llojin e aseteve;
- d) ndikimin e vlerësuar në kapacitetin ndërzonal për drejtim ndërmjet zonave të ofertimit;
- e) arsyet e mosdisponueshmërisë;
- f) datën e parashikuar të fillimit dhe mbarimit (ditën, orën) të ndryshimit të disponueshmërisë.

4.2.2. Informacioni duhet të publikohet sa më shpejt që është e mundur, por jo më vonë se një orë pas marrjes së vendimit në lidhje me mosdisponueshmërinë e planifikuar.

4.2.3 Për informacionin e përcaktuar më lart, Operatori i Sistemit të Transmetimit mund të zgjedhë që të mos identifikojnë asetet në fjalë dhe të mos specifikojë vendndodhjen e tyre, në rast se ajo është klasifikuar si informacion i ndjeshëm dhe kritik lidhur me mbrojtjen e infrastrukturës në Shqipëri, siç parashihet në pikën (d) të nenit 2 të direktivës së Këshillit 2008/114/KE. Kjo nuk cenon detyrimet e përcaktuara në pikën 4.2.1.

##### 4.3 NDRYSHIMET NË DISPONUESHMËRINË FAKTIKE TË INTERKONJEKSIONEVE DHE RRJETIN E TRANSMETIMIT

4.3.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit, për zonën e tij të kontrollit, llogarit dhe i dërgon ENTSO-E-së informacion mbi ndryshimet në disponueshmërinë faktike të interkonjeksioneve dhe në rrjetin e transmetimit që reduktojnë kapacitetet ndërzonale ndërmjet zonave të ofertimit për 100 MW ose më shumë, gjatë së paku një njësie kohore të tregut, duke specifikuar:

- a) identifikimin e aseteve në fjalë;
- b) vendndodhjen;
- c) llojin e aseteve;
- d) efektin në kapacitetin ndërzonal për çdo drejtim ndërmjet zonave të ofertimit;
- e) arsyet e mosdisponueshmërisë;
- f) datën e fillimit dhe datën e parashikuar të mbarimit (ditën, orën) të ndryshimit të disponueshmërisë.

4.3.2 Informacioni duhet të publikohet sa më shpejt që është e mundur, por jo më vonë se një orë pas ndryshimit në disponueshmërinë faktike.

Për informacionin e përcaktuar më lart, Operatori i Sistemit të Transmetimit mund të



zgjedhë që të mos identifikojë asetet në fjalë dhe të mos specifikojë vendndodhjen e tyre, në rast se ajo është klasifikuar si informacion i ndjeshëm dhe kritik lidhur me mbrojtjen e infrastrukturës në Shqipëri, siç parashihet në pikën (d) të nenit 2 të direktivës së Këshillit 2008/114/KE. Kjo nuk cenon detyrimet e përcaktuara në pikën 4.3.1.

#### 4.4 PARASHIKIMI I KAPACITETIT NDËRZONAL

4.4.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit ose Alokuesi i Kapaciteteve të Transmetimit (SEE CAO), për zonën e tij të kontrollit, llogarit dhe i dërgon ENTSO-E-së, para procesit të alokimit informacion për:

a) kapacitetin e parashikuar dhe ofruar (MW) për drejtim ndërmjet zonave të ofertimit në rast të alokimit të kapaciteteve bazuar në kapacitetin e koordinuar neto të transmetimit; ose

b) parametrat kryesorë të bazuara në *flow based*, në rast të alokimit të kapaciteteve bazuar sipas metodologjisë *flow based*.

4.4.2 Informacioni duhet të publikohet sipas afateve të përcaktuara në shtojcën A.

#### 4.5 KAPACITETET E OFRUARA TË TRANSMETIMIT CROSS-BORDER

4.5.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit për zonën e tij të kontrollit llogarit dhe i dërgon ENTSO-E-së, nëse ka alokime eksplicite, për çdo njësi kohore të tregut dhe për drejtimin ndërmjet zonave të ofertimit, të dhënat e mëposhtme:

- kapacitetin (MW) e kërkuar nga tregu;
- kapacitetin (MW) që i alokohet tregut;
- çmimin e kapacitetit (vlera monetare/MW);
- të ardhurat nga ankandet (në vlerë monetare)

për kufirin ndërmjet zonave të ofertimit.

4.5.2 Informacioni duhet të publikohet jo më vonë se një orë pas çdo alokimi të kapaciteteve.

#### 4.6 RAPORTIMI VJETOR RRETH ELEMENTEVE KRITIKE TË RRJETIT QË LIMITOJNË KAPACITETET E OFRUARA

4.6.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit për zonën e tij të kontrollit i dërgon ENTSO-E-së një raport vjetor ku evidentohen:

- elementet kryesore kritike të rrjetit që kufizojnë kapacitetin e ofruar;
- zonën e kontrollit të cilave u përkasin elementet kritike;
- shkallën në të cilën lehtësimi i elementeve kritike të rrjetit do të rriste kapacitetin e ofruar;
- të gjitha masat e mundshme për zbatim për

të rritur kapacitetin e ofruar, së bashku me parashikimin e kostove të tyre.

4.6.2 Gjatë përgatitjes së raportit, Operatori i Sistemit të Transmetimit mund të zgjedhë që të mos identifikojë asetet në fjalë dhe të mos specifikojë vendndodhjen e tyre, në rast se ajo është klasifikuar si informacion i ndjeshëm dhe kritik lidhur me mbrojtjen e infrastrukturës në Shqipëri, siç parashihet në pikën (d) të nenit 2 të direktivës së Këshillit 2008/114/KE.

#### 4.7 KAPACITETI TOTAL I NOMINUAR

4.7.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit për zonën e tij të kontrollit i dërgon ENTSO-E-së kapacitetin total të nominuar për çdo njësi kohore të tregut dhe për çdo drejtim ndërmjet zonave të ofertimit.

4.7.2 Informacioni duhet të publikohet jo më vonë se një orë pas çdo nominimi.

#### 4.8 KAPACITETI TOTAL I ALOKUAR

4.8.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit për zonën e tij të kontrollit, i dërgon ENTSO-E-së para çdo alokimi të kapaciteteve, totalin e kapaciteteve të alokuara përmes procedurave të mëparshme të alokimit për njësi kohore të tregut dhe për çdo drejtim.

4.8.2 Informacioni duhet të publikohet menjëherë sapo të ketë përfunduar dërgimi i të dhënave sipas shtojcës A.

#### 4.9 ÇMIMET E DITËS NË AVANCË

4.9.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit për zonën e tij të kontrollit llogarit dhe i dërgon ENTSO-E-së për çdo njësi kohore të tregut, çmimet e ditës në avancë në zonën e vet përkatëse të ofertimit (EURO/MWh).

4.9.2 Informacioni duhet të publikohet jo më vonë se një orë pas mbylljes së nominimeve (*gate closure*).

#### 4.10 KAPACITETET E OFRUARA TË TRANSMETIMIT CROSS-BORDER NË RASTIN E ALOKIMIT IMPLICIT

4.10.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit për zonën e tij të kontrollit llogarit dhe i dërgon ENTSO-E-së, në rastin e alokimit implicit, për çdo njësi kohore të tregut, pozicionet neto për çdo zonë të ofertimit (MW) dhe të ardhurat e kongestionit (në vlerë monetare) në kufirin ndërmjet zonave të ofertimit.

4.10.2 Informacioni duhet të publikohet çdo ditë jo më vonë se një orë pas kohës së ndërprerjes (*cut off*) dhe në rast se është e



aplikueshme do të përditësohet jo më vonë se dy orë pas çdo nominimi (*intra day*).

#### 4.11 TOTALI I SHKËMBIMIT TREGTAR PËR DITËN NË AVANCË

4.11.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit për zonën e tij të kontrollit llogarit dhe i dërgon ENTSO-E-së shkëmbimet tregtare totale të skeduluara në formë të agreguar ndërmjet zonave të ofertimit për drejtim dhe njësi kohore të tregut.

4.11.2 Informacioni duhet të publikohet çdo ditë, jo më vonë se një orë pas kohës së fundit të ndërprerjes (*cut off*) dhe, nëse është e zbatueshme, përditësohet jo më vonë se dy orë pas çdo procesi të nominimit brenda ditës.

#### 4.12 FLUKSET FIZIKE NË LINJAT E INTERKONJEKSIONIT

4.12.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit për zonën e tij të kontrollit llogarit dhe i dërgon ENTSO-E-së flukset fizike të fuqisë ndërmjet zonave të ofertimit (*Bidding Zones*) për çdo interval të llogaritjes në një ditë.

4.12.2 Informacioni duhet të publikohet jo më vonë se një orë ( $H + 1$ ) pas çdo intervali llogarie për çdo njësi kohore të tregut, sa më afër kohës reale, por jo më vonë se një orë pas periudhës së operimit.

#### 4.13 MENAXHIMI I KONGJESTIONIT - RIDISPEÇERIMI

4.13.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit, për zonën e tij të kontrollit, i dërgon ENTSO-E-së informacion në lidhje me ridispeçerimin për njësi kohore të tregut, duke specifikuar:

- veprimin e ndërmarrë (domethënë rritjen ose uljen e prodhimit dhe ngarkesës);
- identifikimin, vendndodhjen dhe llojin e elementeve të rrjetit që ka të bëjë me veprimin;
- arsyen e ndërmarrjes së veprimit;
- kapacitetin e ndikuar nga veprimi i ndërmarrë (MW).

4.13.2 Informacioni duhet të publikohet sa më shpejt që është e mundur, por jo më vonë se një orë pas periudhës së operimit, përveç për arsye kur duhet të publikohet jo më vonë se një ditë pas periudhës së operimit.

#### 4.14 TREGETIMI NDËRKUFTTAR (COUNTERTRADING)

4.14.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit, për zonën e tij të kontrollit, i dërgon ENTSO-E-së informacion në lidhje me tregtimin ndërkufitar për njësi kohore të tregut, duke specifikuar:

- veprimin e ndërmarrë (domethënë rritjen ose uljen e shkëmbimit ndërzonal);
- zonën e ofertimit;
- arsyen e ndërmarrjes së veprimit;
- ndryshime në shkëmbimin ndërzonal.

4.14.2 Informacioni duhet të publikohet sa më shpejt që është e mundur, por jo më vonë se një orë pas periudhës së operimit, përveç për arsye kur duhet të publikohet jo më vonë se një ditë pas periudhës së operimit.

#### 4.15 RAPORT I MENAXHIMIT TË KONGJESTIONIT

4.15.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit, për zonën e tij të kontrollit, i dërgon ENTSO-E-së informacion në lidhje me kostot mujore të tregtimit ndërzonal dhe ridispeçerimit dhe nga veprime të tjera korrigjuese.

4.15.2 Informacioni duhet të publikohet jo më vonë se dita e fundit e punës të muajit ( $M + 1$ ) pas muajit ( $M$ ), në të cilin janë marrë veprimet e menaxhimit të kongjestionit.

### 5. TË DHËNAT THEMELORE TË TREGUT MBI GJENERIMIN

#### 5.1 FUQIA E PËRGJITHSHME GJENERUESE E INSTALUAR

5.1.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit, për zonën e tij të kontrollit, llogarit dhe i dërgon ENTSO-E-së informacion për sasinë e kapacitetit gjenerues (MW) të instaluar për të gjitha njësitë aktuale të prodhimit që kanë kapacitet gjenerues të instaluar të barabartë ose më të madh se 1 MW, për çdo lloj.

5.1.2 Njësitë gjeneruese dhe njësitë prodhuese do të paraqesin pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit të dhëna të kapacitetit gjenerues të instaluar nga njësitë prodhuese në rrjetin e transmetimit, të përmbledhura sipas tipit të gjeneruesit, jo më vonë se dy javë përpara fillimit të vitit të cilit i përket këto të dhëna.

5.1.3 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ose Operatori i Sistemit të Mbyllur të Shpërndarjes do t'i paraqesë të dhënat pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit mbi kapacitetin gjenerues të instaluar nga njësitë prodhuese në rrjetin e shpërndarjes, të mbledhura sipas tipit të gjeneruesit, jo më vonë se dy javë përpara fillimit të vitit të cilit i përket këto të dhëna.

5.1.4 Të dhënat e mbledhura sipas tipit të prodhimit duhet të publikohen çdo vit jo më vonë se një javë para përfundimit të vitit.



## 5.2 KAPACITETI I INSTALUAR SIPAS NJËSIVE PRODHUESE

5.2.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit, për zonën e tij të kontrollit, llogarit dhe i dërgon ENTSO-E-së informacion në lidhje me njësitë prodhuese (ato aktuale dhe të planifikuara) me kapacitet gjenerues të instaluar të barabartë ose më të madh se 100 MW.

5.2.2 Të dhënat në pikën 5.2.1. duhet të publikohen për periudhën që mbulon tri vitet e ardhshme.

5.2.3 Njësitë Prodhuese do të paraqesin pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit:

- a) emrin e njësisë prodhuese;
- b) kapacitetin gjenerues të instaluar (MW);
- c) vendndodhjen;
- d) nivelin e tensionit në pikën e lidhjes;
- e) tipin e gjeneruesit;
- f) zonën e ofertimit.

5.2.4 Njësitë Prodhuese do të paraqesin të dhënat e pikës 5.2.3 pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit jo më vonë se dy javë përpara fillimit të vitit të cilit i përkasin këto të dhëna.

5.2.5 Të dhënat e pikës 5.2.1. publikohen çdo vit për tri vitet e ardhshme jo më vonë se një javë para fillimit të vitit të parë me të cilin kanë të bëjnë të dhënat.

## 5.3 GJENERIMI I MBLEDHUR I NJË DITE MË PËRPARA

5.3.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit, për zonën e tij të kontrollit, llogarit dhe i dërgon ENTSO-E-së një vlerësim të gjenerimit total të planifikuar (MW) për zonën e ofertimit, për çdo njësi kohore të tregut të ditës së ardhshme;

5.3.2 Njësitë prodhuese do të paraqesin të dhënat pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit të gjenerimit të mbledhur në sistemin e transmetimit për çdo interval të llogarit, jo më vonë se dita që paraprin ditën me të cilën lidhen të dhënat (D-1), deri në orën 14:00.

5.3.3 Në bazë të të dhënave të paraqitura në pikën 5.3.2, Operatori i Sistemit të Transmetimit do të dërgojë të dhënat jo më vonë se ora 18.00 me kohën e Brukselit, një ditë para se të kryhet dorëzimi.

## 5.4 PARASHIKIMI NJË DITË NË AVANCË I GJENERIMIT PËR EOLIKËT DHE FOTOVOLTAIKËT

5.4.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit, për zonën e tij të kontrollit, llogarit dhe i dërgon

ENTSO-E-së një parashikim të gjenerimit të energjisë nga era dhe dielli (MW) për zonën e ofertimit, për çdo njësi kohore të tregut të ditës së ardhshme.

5.4.2 Njësitë prodhuese nga dielli dhe era do të paraqesin këto të dhëna:

a) vlera mesatare e parashikuar e energjisë së gjeneruar nga dielli për secilën njësi kohore tregu, për çdo ditë;

b) vlera mesatare e parashikuar e energjisë së gjeneruar nga era për secilën njësi kohore tregu, për çdo ditë.

5.4.3 Njësitë prodhuese do të paraqesin të dhënat e gjenerimit pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit të mbledhura në sistemin e transmetimit për çdo tip të energjisë elektrike të pikës 5.4.2., jo më vonë se dita që paraprin ditën me të cilën lidhen të dhënat (D-1), deri në orën 14:00.

5.4.4 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ose Operatori i Sistemit të Mbyllur të Shpërndarjes do të paraqesin të dhënat të përmbledhura Operatorit të Sistemit të Transmetimit për çdo tip të energjisë elektrike të pikës 5.4.2. në sistemin e shpërndarjes ose sistemin e mbyllur të shpërndarjes, jo më vonë se dita që paraprin ditën për të cilën lidhen të dhënat (D-1), deri në orën 14:00.

5.4.5 Në bazë të të dhënave të paraqitura në pikën 5.4.2, të dhënat e mbledhura sipas pikës 5.4.1. do të dërgohen jo më vonë se ora 18.00 (sipas orës së Brukselit), një ditë para se të kryhet dorëzimi. Informacioni përditësohet rregullisht dhe publikohen gjatë ditës tregtare me së paku një përditësim, që publikohet në orën 8.00 (sipas orës së Brukselit), në ditën kur kryhet dorëzimi. Informacioni sigurohet për zonën e ofertimit, në rast se ka më shumë se 5% furnizim të gjenerimit të energjisë nga era dhe ajo diellore në vit.

## 5.5 MOSDISPONUESHMËRIA E PLANIFIKUAR E NJËSIVE GJENERUESE

5.5.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit, për zonën e tij të kontrollit, i dërgon ENTSO-E-së të dhënat në lidhje me mosdisponueshmërinë e planifikuar prej 100 MW ose më tepër të një njësie të gjenerimit, duke përfshirë ndryshimet në 100 MW ose më tepër, që pritet të zgjasin së paku një njësi kohore të tregut deri në tre vite.

5.5.2 Njësitë gjeneruese do të paraqesin të dhëna pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit:



- a) emrin e njësisë prodhuese;
- b) emrin e njësisë gjeneruese;
- c) vendndodhjen;
- d) zonën e ofertimit;
- e) kapacitetin e instaluar (MW);
- f) tipin e gjeneruesit;
- g) kapacitetin në dispozicion (vlera neto) të njësisë gjeneruese gjatë ngjarjes;
- h) arsyen për mosdisponueshmërinë;
- i) datën e fillimit dhe datën e parashikuar të mbarimit (ditën, orën) të ndryshimit në disponueshmëri.

5.5.3 Njësitë gjeneruese do të paraqesin të dhëna pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit jo më vonë se 30 minuta pas aprovimit të ndërprerjeve.

5.5.4 Informacioni i pikës 5.5.2. duhet të publikohet sa më shpejt që është e mundur, por jo më vonë se një orë pas marrjes së vendimit në lidhje me mosdisponueshmërinë e planifikuar.

#### 5.6 MOSDISPONUESHMËRIA FAKTIKE E NJËSIVE GJENERUESE

5.6.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit, për zonën e tij të kontrollit, i dërgon ENTSO-E-së të dhënat në lidhje me ndryshimet prej 100 MW ose më tepër në disponueshmërinë e njësisë gjeneruese, që pritet të zgjasin së paku një njësi kohore të tregut.

5.6.2 Njësitë gjeneruese do të paraqesin të dhëna pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit:

- a) emrin e njësisë prodhuese;
- b) emrin e njësisë gjeneruese;
- c) vendndodhjen;
- d) zonën e ofertimit;
- e) kapacitetin gjenerues të instaluar (MW);
- f) tipin e gjeneruesit;
- g) kapacitetin në dispozicion (vlera neto) të njësisë gjeneruese;
- h) arsyen për mosdisponueshmërinë;
- i) datën e fillimit dhe datën e parashikuar të mbarimit (ditën, orën) të ndryshimit në disponueshmëri.

5.6.3 Njësitë gjeneruese do të paraqesin të dhënat e pikës 5.6.2 pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit jo më vonë se 30 minuta pas ndryshimit të disponibilitetit.

5.6.4 Informacioni i pikës 5.6.2 duhet të publikohet sa më shpejt që është e mundur, por jo më vonë se një orë pas ndryshimit në disponueshmërinë faktike.

#### 5.7 MOSDISPONUESHMËRIA E PLANIFIKUAR E NJËSIVE PRODHUESE

5.7.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit, për zonën e tij të kontrollit, i dërgon ENTSO-E-së të dhënat në lidhje me mosdisponueshmërinë e planifikuar të njësisë së prodhimit prej 200 MW ose më tepër, duke përfshirë ndryshimet prej 100 MW ose më tepër në mosdisponueshmërinë e planifikuar të asaj njësie të prodhimit, por jo të publikuara në përputhje me pikën 5.5, që pritet të zgjasë së paku një njësi kohore të tregut deri në tri vite.

Në rastin se këto të dhëna janë publikuar bashkë me të dhënat e pikës 5.5, atëherë Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk do t'i publikojë këto të dhëna në mënyrë të ndarë.

5.7.2 Njësitë prodhuese do të paraqesin të dhëna të mosdisponueshmërisë së prodhimit për një periudhë prej tri vitesh, siç vijon:

- a) emrin e njësisë prodhuese;
- b) vendndodhjen;
- c) zonën e ofertimit;
- d) kapacitetin gjenerues të instaluar (MW);
- e) tipin e gjeneruesit;
- f) kapacitetin disponibël (vlera neto) të njësisë prodhuese gjatë ngjarjes;
- g) arsyen për mosdisponueshmëri;
- h) datën e fillimit dhe datën e parashikuar të mbarimit (ditën, orën) të ndryshimit në disponueshmëri.

5.7.3 Njësitë prodhuese do të paraqesin të dhëna pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit jo më vonë se 30 minuta pas aprovimit të ndërprerjeve.

5.7.4 Informacioni i pikës 5.7.2. do të publikohet sa më shpejt që është e mundur, por jo më vonë se një orë pas marrjes së vendimit në lidhje me mosdisponueshmërinë e planifikuar.

#### 5.8 MOSDISPONUESHMËRIA FAKTIKE E NJËSIVE PRODHUESE

5.8.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit, për zonën e tij të kontrollit, i dërgon ENTSO-E-së të dhënat në lidhje me ndryshimet prej 100 MW ose më tepër në disponueshmërinë aktuale të njësisë së prodhimit me kapacitet gjenerues të instaluar prej 200 MW ose më tepër, por jo të publikuara në përputhje me pikën 5.6, që pritet të zgjasë së paku një njësi kohore të tregut.

5.8.2 Në rastin se këto të dhëna janë publikuar bashkë me të dhënat e pikës 5.6, atëherë Operatori



i Sistemit të Transmetimit nuk do t'i publikojë këto të dhëna në mënyrë të ndarë.

5.8.3 Njësitë prodhuese do të paraqesin të dhëna pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit:

- a) emrin e njësisë prodhuese;
- b) vendndodhjen;
- c) kapacitetin e instaluar (MW);
- d) tipin e gjeneruesit;
- e) zonën e ofertimit;
- f) kapacitetin në dispozicion gjatë ngjarjes;
- g) arsyen për mosdisponueshmëri;

h) datën e fillimit dhe datën e parashikuar e mbarimit (ditën, orën) të ndryshimit në disponueshmëri.

5.8.4 Njësitë prodhuese do të paraqesin të dhënat jo më vonë se 30 minuta pas ndryshimit të disponibilitetit.

5.8.5 Të dhënat e pikës 5.8.3. duhet të publikohen sa më shpejt që është e mundur, por jo më vonë se një orë pas ndryshimit në disponueshmërinë aktuale.

#### 5.9 GJENERIMI FAKTIK PËR NJËSI

5.9.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit, për zonën e tij të kontrollit, llogarit dhe i dërgon ENTSO-E-së të dhënat në lidhje me prodhimin aktual (MW) për njësi kohore të tregut, për njësi të gjenerimit me kapacitet gjenerues të instaluar prej 100 MW ose më tepër.

5.9.2 Njësitë prodhuese do të paraqesin të dhënat pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit sipas pikës 5.9.1 jo më vonë se 4 ditë (D+4) pas ditës (D) me të cilën lidhen të dhënat.

5.9.3 Të dhënat do të publikohen pesë ditë (D+5) pas ditës (D) me të cilën lidhen të dhënat.

#### 5.10 NJËSITË GJENERUESE TË MBLEDHURA SIPAS TIPIT

5.10.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit për zonën e tij të kontrollit, llogarit dhe i dërgon ENTSO-E-së të dhënat në lidhje me gjenerimin faktik të mbledhur (vlera neto) për njësi gjeneruese (vlera mesatare e mbledhur) për çdo interval të llogaritur në ditën (D), prodhimi i agreguar i gjenerimit për njësi kohore për çdo lloj.

5.10.2 Njësitë prodhuese do të paraqesin të dhënat pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit për njësitë gjeneruese të lidhura në sistemin e transmetimit jo më vonë se 30 minuta pas çdo intervali të llogaritur.

5.10.3 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ose Operatori i Sistemit të Mbyllur të Shpërndarjes do të paraqesë pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit të dhënat të përmbledhura sipas njësisë gjeneruese në sistemin e shpërndarjes ose në sistemin e mbyllur të shpërndarjes, maksimalisht 30 minuta pas çdo intervali të llogaritur.

5.10.4 Të dhënat e pikës 5.10.1 mblidhen sipas tipit të gjenerimit dhe duhet të publikohen jo më vonë se një orë pas çdo intervali të llogaritur.

#### 5.11 GJENERIMI FAKTIK PËR EOLIKËT DHE FOTOVOLTAIKËT

5.11.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit për zonën e tij të kontrollit, llogarit dhe i dërgon ENTSO-E-së të dhënat në lidhje me gjenerimin aktual ose të parashikuar të energjisë së erës dhe asaj diellore (MW) në zonën e ofertimit për njësinë kohore të tregut.

5.11.2 Njësitë prodhuese do të paraqesin të dhëna pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit për njësitë prodhuese të lidhura në sistemin e transmetimit jo më vonë se 30 minuta pas çdo intervali të llogaritur.

5.11.3 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ose Operatori i Sistemit të Mbyllur të Shpërndarjes do të paraqesë te Operatori i Sistemit të Transmetimit të dhënat e grumbulluara në Sistemin e Shpërndarjes ose në Sistemin e Mbyllur të Shpërndarjes, maksimumi 30 minuta pas çdo intervali llogaritës.

5.11.4 Informacioni duhet të publikohet jo më vonë se një orë pas periudhës së operimit dhe përditësohet bazuar në vlerat e matura sa më shpejt që ato vihen në dispozicion. Informacioni sigurohet për zonën e ofertimit në rast se ka më shumë se 5% furnizim të gjenerimit të energjisë nga era dhe ajo diellore në vit.

#### 5.12 REZERVA ENERGJETIKE

5.12.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit, për zonën e tij të kontrollit, i dërgon ENTSO-E-së të dhënat në lidhje me vlerën e agreguar të shkallës mesatare javore të mbledhur të mbushjes së të gjithë rezervuarëve të ujit të hidrocentraleve (MWh), për zonën e vet përkatëse të ofertimit, përfshirë shifrën për javën e njëjtë të vitit të kaluar.

5.12.2 Informacioni duhet të publikohet ditën e tretë të punës pas javës me të cilën ka të bëjë informacioni. Informacioni sigurohet për zonën e ofertimit, në rast se ka më shumë se 30% furnizim të këtij lloji të gjenerimit në vit.



## 6. TË DHËNAT THEMELORE TË TREGUT PËR BALANCIMIN

### 6.1 RREGULLAT E BALANCIMIT

6.1.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit, për zonën e tij të kontrollit, i dërgon ENTSO-E-së informacion në lidhje me rregullat mbi balancimin, i cili përfshin:

a) proceset për prokurimin e llojeve të ndryshme të rezervave balancuese dhe energjisë balancuese;

b) metodologjinë e pagesës për sigurimin e rezervave dhe energjinë e aktivizuar për balancim;

c) metodologjinë e llogaritjes së tarifave të mosbalancimit;

d) nëse është e zbatueshme, një përshkrim se si kryhet balancimi ndërkufitar ndërmjet dy ose më shumë zonave të kontrollit dhe kushtet e pjesëmarrjes së gjeneratorëve dhe ngarkesës.

### 6.2 SASIA E REZERVAVE BALANCUESE TË KONTRAKTUAR

6.2.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit, për zonën e tij të kontrollit, i dërgon ENTSO-E-së informacion në lidhje me sasinë e rezervave balancuese (MW) sipas kontratës (MW) nga OST-ja.

6.2.2 Të dhënat të cilat do të publikohen:

a) burimin e rezervës (gjenerim ose ngarkesë);

b) llojin e rezervave (p.sh., rezerva për kontrollin e frekuencës, rezerva për rivendosjen e frekuencës, rezerva për zëvendësim);

c) periudhën kohore për të cilën janë kontraktuar rezervat (p.sh.: orën, ditën, javën, muajin, vitin etj.).

6.2.3 Informacioni duhet të publikohet sa më parë të jetë e mundur, por jo më vonë se dy orë para se të zhvillohet procesi i radhës i prokurimit.

### 6.3 ÇMIMET E KAPACITETIT REZERVË TË REZERVAVE BALANCUESE

6.3.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit, për zonën e tij të kontrollit, i dërgon ENTSO-E-së çmimet e paguara nga OST-të për llojin e rezervave balancuese të prokuruar dhe për periudhën e prokurimit (LEKË/MW/periudha);

6.3.2 Të dhënat duhet të publikohen sa më shpejt që është e mundur, por jo më vonë se një orë pas përfundimit të periudhës së operimit.

### 6.4 OFERTAT TOTALE TË PRANUARA

6.4.1 Operatori i Sistemit të Transmisimit, për zonën e tij të kontrollit, i dërgon ENTSO-E-

së ofertat e pranuar të mbledhura për njësinë kohore të balancimit, veçmas për secilin lloj të rezervave të balancimit.

6.4.2 Të dhënat duhet të publikohen sa më shpejt që është e mundur, por jo më vonë se një orë pas periudhës së operimit.

### 6.5 VËLLIMET E REZERVAVE TË AKTIVIZUARA TË BALANCIMIT

6.5.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit, për zonën e tij të kontrollit, i dërgon ENTSO-E-së sasinë e energjisë së aktivizuar balancuese (MW) për njësinë kohore të balancimit dhe për llojin e rezervave.

6.5.2 Do të publikohet informacioni i mëposhtëm:

a) energjia balancuese e aktivizuar (MWh) në intervalin llogaritës;

b) lloji i energjisë balancuese të aktivizuar (sekondare dhe terciare);

c) burimi i rezervës së energjisë balancuese të aktivizuar (gjenerim ose ngarkesë);

d) drejtimi i rregullimit (rregullimi nga lart ose rregullimi nga poshtë).

6.5.3 Të dhënat duhet të publikohen sa më shpejt që është e mundur, por jo më vonë se 30 minuta pas periudhës së operimit. Në rast se të dhënat janë paraprake, shifrat duhet të përditësohen atëherë kur të dhënat vihen në dispozicion.

### 6.6 ÇMIMET E REZERVAVE TË AKTIVIZUARA TË BALANCIMIT

6.6.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit, për zonën e tij të kontrollit, i dërgon ENTSO-E-së çmimet e paguara nga OST-të për energjinë e aktivizuar të balancimit për njësinë kohore të balancimit dhe për llojin e rezervave. Informacioni në lidhje me çmimin duhet të jepet ndarazi për rregullimin e lartë dhe të ulët.

6.6.2 Në rast se Operatori i Sistemit të Transmetimit shet/blet energji balancuese me qëllim balancimin e sistemit sipas metodës së çmimit marxhinal, çmimi marxhinal i të gjitha ofertave të aktivizuara në periudhën llogaritëse përkatëse do të publikohet.

6.6.3 Të dhënat duhet të publikohen sa më shpejt që është e mundur, por jo më vonë se një orë pas periudhës së operimit.

### 6.7 ÇMIMI I DISBALANCEVE

6.7.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit, për zonën e tij të kontrollit, i dërgon ENTSO-E-së të





dhëna në lidhje me çmimin e disbalancave (EUR/MWh) për njësi kohore të balancimit.

6.7.2 Të dhënat duhet të publikohen sa më shpejt që është e mundur.

#### 6.8 VËLLIMI TOTAL I DISBALANCAVE

6.8.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit, për zonën e tij të kontrollit, i dërgon ENTSO-E-së të dhëna në lidhje me vëllimin total të disbalancave të zonës së kontrollit për njësi kohore të balancimit.

6.8.2 Të dhënat do të publikohen sa më shpejt që është e mundur, por jo më vonë se 30 minuta pas periudhës së operimit. Në rast se të dhënat janë paraprake, shifrat duhet të përditësohen atëherë kur të dhënat vihen në dispozicion.

#### 6.9 BALANCA MUJORE FINANCIARE

6.9.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit, për zonën e tij të kontrollit, i dërgon ENTSO-E-së të dhëna mbi bilancin mujor financiar zonës së vet përkatëse të kontrollit, duke specifikuar:

a) shpenzimet që i janë shkaktuar OST-së për prokurimin e rezervave dhe aktivizimin e energjisë balancuese;

b) të ardhurat neto të OST-së pas shlyerjes së llogarive jo të balancuar me palët përgjegjëse të bilancit;

6.9.2 Të dhënat do të publikohen sa më shpejt që është e mundur, por jo më vonë se 3 muaj pas periudhës së operimit. Në rast se të zgjidhjet janë paraprake, shifrat duhet të përditësohen pas zgjidhjeve përfundimtare.

6.9.3 Në rast të korigjimit të bilancit financiar, Operatori i Sistemit të Transmetimit do të publikojë të dhënat e korigjuara nga pika 6.9.1.

#### 6.10 BALANCIMI NDËRZONAL

6.10.1 Në ato raste kur është e mundur, Operatori i Sistemit të Transmetimit i dërgon ENTSO-E-së informacion lidhur me Zonën e Kontrollit Ndërzonal për çdo njësi kohore balancimi, e cila përfshin:

a) sasinë e kërkesave dhe ofertave e shkëmbyera për njësi kohore të prokurimit;

b) çmimet maksimale dhe minimale të kërkesave dhe ofertave të shkëmbyera për njësi kohore të prokurimit;

c) sasinë e energjisë balancuese të aktivizuar në zonën e kontrollit në fjalë.

6.10.2 Të dhënat do të publikohen sa më shpejt që është e mundur, por jo më vonë se një orë pas periudhës së operimit.

#### 7. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

7.1.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit do të publikojë të dhënat e përcaktuara në pikat 3.6, 3.7, 4.4, 4.5, 4.7, 4.8, 4.10, 4.14, 4.17, 4.11, 5.2, 5.5, 5.6, 5.7, 5.8, menjëherë, me hyrjen në fuqi të këtyre rregullave.

7.1.2 Operatori i Sistemit të Transmetimit do të publikojë të dhënat e përcaktuara në nenet 4.1 dhe 6 të këtyre rregullave, duke filluar nga data 1 shtator 2017.

7.1.3 Operatori i Sistemit të Transmetimit do të publikojë të dhënat e përcaktuara në nenet 3.1, 3.2, 3.3, 3.4, 3.5, 3.8, 4.2, 4.3, 4.6, 4.12, 4.13, 5.1, 5.3, 5.9, 5.10, 5.12 të këtyre rregullave, duke filluar nga data 1 janar 2018.

7.1.4 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të dorëzojë të dhënat e përcaktuara në këtë rregullore tek Operatori i Sistemit të Transmetimit, duke filluar nga data 1 janar 2018.

7.1.5 Prodhuesi do të dorëzojë të dhënat e përcaktuara në këtë rregullore tek Operatori i Sistemit të Transmetimit duke filluar nga data 1 janar 2018.

7.1.6 Të dhënat në lidhje me parashikimin dhe prodhimin aktual nga energjia diellore dhe ajo e erës nga nenet 5.4 dhe 5.11 të këtyre rregullave do të publikohet atëherë kur pjesa e energjisë elektrike të prodhuar nga këto burime të rinovueshme të tejkalojë 5% të totalit të prodhimit vjetor të energjisë elektrike. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të informojë në kohë prodhuesit, Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes dhe Operatorët e Sistemeve të Mbyllura të Shpërndarjes në lidhje me plotësimin e kushtit të mësipërm.

7.1.7 Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga ana e bordit të ERE-s.



## SHTOJCA A

## Publikimi i informatave të referuara në pikën 4.4

Periudha e alokimit kapaciteteve	Kapaciteti ndërzonal i parashikuar që duhet publikuar	Kapaciteti i ofruar që duhet publikuar
Vjetore	Një javë para procesit vjetor të alokimit, por jo më vonë se 15 dhjetor, për të gjithë muajt e vitit të ardhshëm	Një javë para procesit vjetor të alokimit, por jo më vonë se 15 dhjetor
Mujore	Dy ditë pune para procesit mujor të alokimit, për të gjitha ditët pas muajt të ardhshëm	Dy ditë pune para procesit mujor të alokimit
Javore	Çdo të premte, për të gjitha ditët e javës së ardhshme	Një ditë para procesit javor të alokimit
Për ditën pasuese		Një orë para mbylljes së portës së tregut të vendit, për çdo njësi kohore të tregut
Brenda ditës		Një ditë para alokimit të parë brenda ditës dhe pastaj në kohë reale, për çdo njësi kohore të tregut

## VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr.968, datë 31.5.2017, vendosi shpalljen të vdekur, në datën 1.1.1996, të shtetasit Stiliano Elmazi i biri i Demirit dhe i Zaidesë, i datëlindjes 4.4.1976.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2017

Adresa:  
Bulevardi “Gjergj Fishta”  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 140 lekë